



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER  
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 6272 Prot.

Fier, më 18.05 2026

PROJEKT VENDIM  
Nr. 44, datë 18.05 2026

PËR DHËNIE NDIHME SHTETËRORE FINANCIARE

Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasës Lindita Lako, lagjja "Afrimi i Ri", Njësia Administrative nr.4, e dëmtuar nga zjarri i datës 24.04.2026.

Në mbështetje të nenit 3, pikës 1.1 të nenit 9, dhe nenit 29 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" (i ndryshuar), nenit 30 dhe 41 të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "*Për Mbrojtjen Civile*", ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier nr.118, datë 11.12.2025 "*Për miratimin e buxhetit të vitit 2026*" si dhe në zbatim të shkronjave "e" dhe "ë" të pikës 1, të paragrafit III, të V.K.M-së Nr.329 datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", kreu III pika 1, për dëmin e shkaktuar nga zjarri i datës 24.04.2026, shkresës zyrtare nr.459/1.prot, datë 14.05.2026 "*Vlerësim dëmi*" të Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Zhvillimit të Projekteve, Këshilli i Qarkut Fier, si dhe Preventivit bashkëlidhur kësaj shkrese, ku ka rezultuar se në banesën e shtetasës Lindita Lako dëmi në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake është në vlerën **105 000 (njëqind e pesë mijë) lekë** dhe në anën ndërtimore në vlerën **22 428 (njëzetë e dy mijë e katërqind e njëzetë e tetë) lekë**, ndaj bazuar në nenin 30, shkronja "gj", e ligjit 45/2019, Drejtoria e Mbrojtjes Civile,

PROPOZON:

1. Dhënien e ndihmës financiare prej Bashkisë Fier për shtetasen Lindita Lako, në masën **100%**, për dëmet e shkaktuara në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, në vlerën prej **105 000 (njëqind e pesë mijë) lekë**.
2. Dhënien e ndihmës prej Bashkisë Fier në masën **50%**, për dëmet e shkaktuara në anën ndërtimore të banesës, në vlerën prej **11 214 (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e katërmëdhjetë) lekë**, konform përcaktimeve ligjore të pikës 3, gërmës "ç" "Përcaktimi i ndihmës financiare" e VKM nr.329 datë 16.05.2012.
3. Vlera totale financiare e dhënies së ndihmës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij projekt vendimi për shtetasen Lindita Lako është në masën **116 214 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e katërmëdhjetë) lekë**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile si dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

**Drejtoria e Mbrojtjes Civile**  
Nasip BANI

**Drejtoria Juridike**  
Esmeralda KAPLLANAJ

**Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.**  
Pranvera ÇINA

**KRYETARI**  
Armando SUBASHI

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZËVENDËS KRYETAR**

Nustret AVDULLA

